



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:079592

Datë: 19.07.2024

Numri i dokumentit: 05956104

C.nr.305/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoreshen profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike të paditësit E (M) H nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, kundër të paditurve: 1.I.G, 2.L.G, 3.F.D, 4.B.M, 5.S.D, 6.A.G, 7.Z.G, 8.M.P, 9.II.G, 10.I2.G, 11.I3.G, 12.V.F, 13.F.G, 14.H.G, 15.S.G, 16.H1.G, 17.A1.G, 18.B.G, 19.Xh.G, dhe 20.A.H, që të gjithë nga fshati Krushë e Madhe Komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson avokati R.B nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, vlera e objektit të kontestit 2,400.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor më datën 19.07.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Në bazë të pohimit

I. APROVOHET NË TËRËSI e bazuar kërkesëpadia e paditësit E (M) H nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit.

II. VËRTETOHET se paditësi E (M) H nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, në bazë të parashkrimit fitues është pronar i paluajtshmërisë së evidentuar si njësi kadastrale me nr.02157-1, ZK Krushë e Madhe, pronë private, vendi i quajtur “Ksola - Moriza”, me kulturë ”Arrë e klasës 2”, me sipërfaqe prej 4194 m², e cila kufizohet në veriperëndim me parcelat: nr.2160-0 ZK Krushë e Madhe dhe nr.2158-0 ZK Krushë e Madhe, në verilindje me parcelën nr.2169-0 ZK Krushë e Madhe, në juglindje me parcelat: nr.2151-2 ZK Krushë e Madhe, nr.2151-3 ZK Krushë e Madhe, nr.2151-4 ZK Krushë e Madhe dhe nr. 2157-2 ZK Krushë e Madhe, si dhe në jugperëndim me parcelën nr. 2156-0 ZK Krushë e Madhe.

III. DETYROHEN të paditurit: 1.I.G, 2.L.G, 3.F.D, 4.B.M, 5.S.D, 6.A.G, 7.Z.G, 8.M.P, 9.II.G, 10.I2.G, 11.I3.G, 12.V.F, 13.F.G, 14.H.G, 15.S.G, 16.H1.G, 17.A1.G, 18.B.G, 19.Xh.G, dhe 20.A.H, që të gjithë nga fshati Krushë e Madhe Komuna e Rahovecit, që ta pranojnë këtë të drejtë dhe që të lejojnë regjistrimin e paluajtshmërisë nr.02157-1, ZK Krushë e Madhe, në emër të paditësit në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Rahovecit, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit.

IV. Shpenzimet procedurale i bartë pala paditëse.

A r s y e t i m

Paditësi E (M) H nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, në këtë gjykatë ka parashtuar padi kundër të paditurve: 1.I.G, 2.L.G, 3.F.D, 4.B.M, 5.S.D, 6.A.G, 7.Z.G, 8.M.P, 9.II.G, 10.I2.G, 11.I3.G, 12.V.F, 13.F.G, 14.H.G, 15.S.G, 16.H1.G, 17.A1.G, 18.B.G, 19.Xh.G, dhe 20.A.H, që të gjithë nga fshati Krushë e Madhe Komuna e Rahovecit, për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të parashkrimit fitues (mbajtjes) në paluatjshmërinë - parcelën me numër Nr.2157-1, Zona Kadastrale Krushë e Madhe, kërkesëpadija është precizuar në seancën shqyrtimit përgatitor të datës 29.05.2024.

Paditësit si në padi ashtu edhe në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas parashkrimit të padisë ka ardhur deri te ndryshimi i numrit dhe të sipërfaqes të parcelës që është cekur në kërkesëpadi, andaj në vend të të numrit të parcelës 02157-0, duhet të jetë 02157-1, si dhe në vend të sipërfaqes 47.50ha, duhet të jetë 41.97 ha. Duke shtuar se tani e tutje objekt i shqyrtimit të kërkesëpadiës nuk është parcela 02157-0, por është në tërësi parcela numër 02157-1 ZK Krushë e Madhe. I njëjti ka theksuar se nga provat e administruara është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadiës, ku edhe të paditurit e pohojnë një fakt të tillë. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadiën ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet procedural ka deklaruar se do ti bartë paditësi.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurve në përgjigjen në padi, seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi e pranojnë kërkesëpadiën e paditësit, ngase e vërteta është që i ati i paditësit prej të ndjerit A2.G nga Krushë e Madhe, përndryshe i ati, përkatësisht gjyshi i të paditurve, mbi 25 vite më herët e më herët ka blerë parcelën tani me numër 02157-1, që është në sipërfaqe të përgjithshme prej 41.94 ha, që gjendet në vendin e ashtuquajtur “Ksolla-Moriza” në Krushë të Madhe. Gjithashtu, është e vërtetë që i ati i paditësit atëherë paraardhësit të të paditurve në tërësi ia paguar shumën kontraktuese dhe që nga ajo kohë e ka shfrytëzuar i ati i paditësit, e në ndërkohë tani kjo parcelë me rastin e ndarjes i ka takuar paditësit. Të paditurit pranojnë që kjo parcelë tani të bartet në emër të paditësit, e cila ende është e regjistruar në emër të të ndjerit, ngase atëherë kur është kryer shitblerja nuk është bërë kontratë formale, përkatësisht me shkrim, për këtë arsye parcela ende është e regjistruar në emër të të ndjerit. Pasi që me vetë aktin e shitblerjes, i ati, përkatësisht paditësi është bërë pronar faktik i parcelës në fjalë, të paditurit nuk e kontestojnë këtë të drejtë dhe e pohojnë në tërësi kërkesëpadiën e paditësit siç është precizuar në seancën nga paditësi. I njëjti ka theksuar se në bazë të provave të proceduara është vërtetuar se i ati i paditësit para 20 vjetëve parcelën në fjalë e ka blerë, të njëjtën është duke e shfrytëzuar dhe në bazë të posedimit faktik dhe mbajtjes me mirëbesim, është pronar i parcelës në fjalë, e këtë fakt ia pranojnë edhe të paditurit, prandaj nuk e kontestojnë kërkesëpadiën e paditësit.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike ka caktuar shqyrtimin kryesor në të cilin kanë prezantuar palët ndërgjyqëse. Ka caktuar ekspertizën e gjeodezisë dhe se bashku me palët ndërgjyqëse ka dalë në vend. Eksperti i gjeodezisë është obliguar që të bëjë identifikimin e parcelës, sipërfaqen, kufizimet e parcelës dhe kush është në shfrytëzim të saj.

Gjithashtu, për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave:

- Certifikatën e pronës, me nr. të lëndës 08-942/03-0014758/21, e datës 06.04.2021;
- Dëshmi vdekje, me nr. 12/2021, e përpiluar me datë data..., për të ndjerin H.A.G;
- Dëshminë e vdekjes, me nr. 13/2021, e përpiluar me datë data..., për të ndjerin I.A.G;
- Dëshminë e vdekjes, me nr. 11/2021, e përpiluar me datë data..., për të ndjerin A.A.G;
- Dëshminë e vdekjes, me nr. 10/2021, e përpiluar me datë data..., për të ndjerin A.B.G;
- Certifikatën e vdekjes, me nr.ser. V10395579, e datës data..., për të ndjerin I.G, e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Krushë të Madhe-Rahovec;
- Certifikatën e vdekjes, me nr.ser. V10395568, e datës data..., për të ndjerin H.G, e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Krushë të Madhe-Rahovec;
- Certifikatën e vdekjes, me nr.ser. V10395082, e datës data..., për të ndjerin A.G, e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Krushë të Madhe-Rahovec;
- Certifikatën e vdekjes, me nr.ser. V10395079, e datës data..., për të ndjerin A.G, e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Krushë të Madhe-Rahovec;
- Certifikatën e pronës, me nr. të lëndës 08-942/03-0020982/24, e datës 29.05.2024;
- Ekspertizën e gjeodezisë, e punuar nga eksperti Sh.H, e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 10.06.2024.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar duke qenë se të paditurit e kanë pohuar kërkesëpadinë, që nga fillimi i procedurës e deri në përfundim të saj, ku të paditurat I.I.G, 2.L.G, 3.F.D, 4.B.M, 5.S.D, 6.A.G, 7.Z.G, 8.M.P, 9.II.G, 10.I2.G, 11.I3.G, 12.V.F, 13.F.G, 14.H.G, 15.S.G, 16.H1.G, 17.A1.G, 18.B.G, 19.Xh.G, dhe 20.A.H pohimin e kërkesëpadisë e kanë bërë përmes përfaqësuesit të autorizuar të tyre, në këtë rast avokatit të tyre.

Gjykata me administrimin e certifikatës së paluajtshmërisë 08-942/03-0055898/22, e datës 27.12.2022 dhe ekspertizës së gjeodezisë të datës 16.05.2024 (të cilave ua dha besimin e plotë) ka vërtetuar faktin se parcela nr. 01460-3 Zona Kadastrale Xërxë, me sipërfaqe prej 2117 m² evidentohet në emër të të paditurave Sh.B.Th, N.B.Th dhe Q.B.G, me pjese ideale 1/3.

Gjykata me administrimin e certifikatës së paluajtshmërisë nr. të lëndës 08-942/03-0020982/24, e datës 29.05.2024 dhe ekspertizës së gjeodezisë të datës 10.06.2024 (të cilave ua dha besimin e plotë) ka vërtetuar faktin se parcela nr.02157-1, Zona Kadastrale Krushë e Madhe, me sipërfaqe prej 4194 m² evidentohet në emër të të ndjerit A2.B.G (paraardhës i të paditurve I.I.G, 2.L.G, 3.F.D, 4.B.M, 5.S.D, 6.A.G, 7.Z.G, 8.M.P, 9.II.G, 10.I2.G, 11.I3.G, 12.V.F, 13.F.G, 14.H.G, 15.S.G, 16.H1.G, 17.A1.G, 18.B.G, 19.Xh.G, dhe 20.A.H), me pjese ideale 1/1.

Gjykata nga shqyrtimi i gjithmbarshëm i çështjes, edhe përkundër pohimit të kërkesëpadisë nga të paditurat, ka shtyrë marrjen e aktgjykimit në bazë të pohimit, kurse sipas propozimit të paditësit me qëllim të verifikimit dhe marrjes së njoftimeve të duhura në kuptim të nenit 3 të

Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka caktuar seancën e vend shikimit dhe nxjerrjen e provës përmes ekspertizës së gjeodezisë.

Gjykata pas analizimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, thëniet në padi dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga i padituri, ka gjetur se janë në harmoni me njëra tjetrën dhe me pohimin e palës së paditur, nga të cilat vërtetohen faktet relevante se palët mund të disponojnë me kërkesat e tyre, pasi që paditësit janë të evidentuara si pronarë të paluajtshmërive, që vërtetohet përmes certifikatës së pronës me nr. të lëndës 08-942/03-0020982/24, e datës 29.05.2024.

Gjykata pas pohimit të kërkesëpadsisë nga ana e të paditurve përmes të autorizuarit të tyre, konstatoi se kërkesa është e disponueshme për palët, prandaj në kuptim të nenit 148.1 të Ligjit të procedurës Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se i padituri deri në përfundim të shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadsinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesën (aktgjykimin në bazë të pohimit)”,* vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pasi që paditësi në padi ka deklaruar se do ti bartë shpenzimet e kësaj procedure, si dhe në kuptim të nenit 455 LPK-së, gjykata ka vendosur sikurse në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Mbi bazën e parashtrimeve të mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143 dhe 148.1 të LPK-së.

GJYKATA E THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.305/2021 më datë 19.07.2024

Gjyqtari
Berkan Hamza

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët mund të ushtrojnë ankese në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate. Në kuptim të nenit 181 par.2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.

Numri i lëndës: 2021:079592
Datë: 19.07.2024
Numri i dokumentit: 05956104